





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DREJTORIA E ARSIMIT



PLANI I PUNËS

PËR VITIN 2026

Mitrovicë, Janar 2026

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Lista e shkurtesave	3
Hyrje	4
Sektori për Arsim	5
Objektivat e Sektorit për Arsim	7
Tabela vjetore e aktiviteteve kryesore të planifikuara për vitin 2026	8
Të dhënat e përgjithshme	13
Numri i nxënësve sipas niveleve shkollore	13
Pasqyra e numrit të paraleleve sipas klasave	14
Pasqyra e numrit të nxënësve sipas Institucioneve Edukativo - Arsimore	15
Numri i nxënësve sipas strukturës etnike në vitin shkollor 2025/26	16
Numri i nxënësve me nevoja të veçanta në vitin shkollor 2025/26	16
Sektori për Administratë dhe Financa	17
Objektivat e Sektorit për Administratë	17
Aktivitetet e Sektorit për Buxhet dhe Financa në vitin 2026	19
Buxheti 2026 - Arsim dhe shkencë	27

Lista e shkurtesave

AP	Aktivitet Profesionale
DA	Drejtoria e Arsimit
EPRBM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit
EVPFNVA	Ekipi për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore
IAAP	Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional
IEAA	Institucionet Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese
IP	Institucion Parashkollor
KK	Kuvendi Komunal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
OS	Objektivi Strategjik
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
PZhA	Plani i Zhvillimit të Arsimit
QPS	Qendra për Punë Sociale
SA	Spektori për Arsim
SAF	Spektori për Administratë dhe Financa
SIA	Spektori i Inspeksionit të Arsimit
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
SNKA	Sistemi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit
ShML	Shkolla e Mesme e Lartë
SHF	Shoqata e Fizikanëve
ShM	Shoqata e Matematikanëve
VPM	Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësve
ZI	Zyra e Informimit
ZK	Zyra e Kuvendit
ZhPMBSH	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve me Bazë në Shkollë

Hyrje

Plani Vjetor i Punës për vitin 2026 i Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut paraqet dokumentin themelor të planifikimit strategjik dhe operacional për zhvillimin dhe funksionimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel komunal. Ky plan përfshin objektivat, masat dhe aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit, të cilat do të zbatohen gjatë vitit 2026 në të gjitha institucionet edukativo-arsimore.

Plani mbulon të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit (SNKA):

- SNKA 3 - Arsimi i Mesëm i Lartë (Klasat X-XII),
- SNKA 2 - Arsimi i mesëm i ulët (Klasat VI-IX),
- SNKA 1 - Arsimi fillor (Klasat I-V),
- SNKA 0 - Klasat Parafilllore/Përgatitore (5-6 vjeç) dhe Arsimi Parashkollor (lindje-5 vjeç).

Ky plan është hartuar në përputhje me Ligjin për Arsimin Parauniversitar, politikat dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), si dhe dokumentet strategjike dhe rregullative në fuqi. Plani synon sigurimin e funksionimit të rregullt, efikas dhe cilësor të sistemit arsimor, duke garantuar kushte të barabarta dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit.

Vizioni i Drejtorisë së Arsimit është krijimi i një sistemi bashkëkohor të arsimit që ofron mësimdhënie cilësore, zhvillim të potencialit të secilit nxënës dhe kushte të sigurta për mësim dhe punë edukativo-arsimore. Në funksion të këtij vizioni, misioni i Drejtorisë së Arsimit është ofrimi i arsimit cilësor përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm të mësimdhënësve, përdorimit të teknologjisë moderne, forcimit të mekanizmave të cilësisë dhe sigurimit të qeverisjes transparente dhe llogaridhënëse.

Zbatimi i Planit Vjetor të Punës për vitin 2026 kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërmjet sektorëve të Drejtorisë së Arsimit, institucioneve arsimore dhe partnerëve relevantë, me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Sektori për Arsim

Plani Vjetor i Punës për vitin 2026 i Sektorit për Arsim (SA) paraqet dokumentin operativ për zbatimin e objektivave strategjike të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut në fushën e arsimit parauniversitar. Ky plan është hartuar në përputhje me kompetencat ligjore të komunës, Ligjin për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, politikat, dokumentet strategjike, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

Në funksion të vizionit dhe misionit të Drejtorisë së Arsimit (DA), Sektori për Arsim (SA) synon sigurimin e funksionimit të rregullt, efikas dhe cilësor të arsimit parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në nivel komunal, përmes planifikimit të aktiviteteve konkrete, koordinimit institucional dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor. Fokus i veçantë i këtij plani është krijimi dhe ruajtja e një mjedisi arsimor të sigurt dhe gjithëpërfshirës, që siguron mbështetje të përshtatur sipas nevojave të nxënësve.

Gjatë vitit 2026, Sektori për Arsim do të angazhohet në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies përmes zbatimit të kurrikulës dhe planeve mësimore, monitorimit sistematik të punës në institucionet arsimore dhe forcimit të bashkëpunimit me shkollat, prindërit, nxënësit dhe partnerët relevantë. Njëkohësisht, do të monitorohet dhe sigurohet mbledhja, përpunimi, raportimi dhe analizimi i të dhënave arsimore në nivel komunal, në funksion të planifikimit dhe vendimmarrjes së bazuar në evidencë, në përputhje me kërkesat e MASHTI-t.

Plani Vjetor i Punës i Sektorit për Arsim ka për qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve në fëmijërinë e hershme, sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm të ekipit për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, si dhe mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta dhe të atyre me talente dhe aftësi të jashtëzakonshme. Plani gjithashtu ka për qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve profesionale mbështetëse, sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve dhe parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.

Zbatimi i planit do të përballlet me disa sfida kryesore, ku ndër kryesoret mund të veçohen:

- Rritja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm;
- Sigurimi i mbështetjes financiare për funksionimin e qëndrueshëm të ekipit për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Rritja e numrit të stafit profesional mbështetës, si: psikologë, pedagogë, mësimdhënës mbështetës dhe asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Mbështetja për krijim dhe funksionim të qëndrueshëm të mekanizmave për sigurimin e cilësisë;
- Mbështetja për fuqizimi e Aktiveve Profesionale (AP) në të gjitha IEAA dhe në nivel komune;
- Sigurimi i mbështetjes financiare për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve;
- Zbatimi efektiv i Planit Komunal të Veprimit për Parandalimin e Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Shkollë 2024–2026, i cili do të ndikohet nga mungesa e mjeteve dhe resurseve të nevojshme.

Në përfundim, ky Plan Vjetor i Punës për vitin 2026 paraqet bazën për organizimin, koordinimin dhe realizimin e aktiviteteve të Sektorit për Arsim, në funksion të përmbushjes së objektivave të përgjithshme të Drejtorisë së Arsimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë përmes qasjes gjithëpërfshirëse dhe të drejtë në arsimin parauniversitar në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Objektivat e Sektorit për Arsim

Objektivat e Sektorit për Arsim (SA) për vitin 2026 janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me objektivat strategjike të Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, si dhe me prioritetet e përcaktuara nga Drejtoria e Arsimit dhe politikat arsimore në nivel qendror. Këto objektiva synojnë orientimin e veprimeve dhe aktiviteteve të sektorit drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit parauniversitar, forcimit të mekanizmave të sigurimit të cilësisë, rritjes së gjithëpërfshirjes dhe mbështetjes së bazuar në nevojat e nxënësve, si dhe avancimit të planifikimit dhe vendimmarrjes së bazuar në të dhëna. Në këtë kuadër, Sektori për Arsim ka përcaktuar objektivat vijuese:

Objektivi 1:

Monitorimi i vazhdueshëm i mbarëvajtjes së procesit edukativo-arsimor në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar në nivel komunal.

Objektivi 2:

Krijimi dhe fuqizimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë në institucionet arsimore komunale.

Objektivi 3:

Zhvillimi dhe avancimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve, udhëheqësve të institucioneve arsimore dhe personelit profesional.

Objektivi 4:

Rritja e gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor, duke siguruar mbështetje të përshtatur sipas nevojave të nxënësve dhe duke promovuar pjesëmarrjen aktive pa diskriminim dhe me respektim të diversitetit.

Objektivi 5:

Përmirësimi i menaxhimit, përpunimit dhe shfrytëzimit të të dhënave arsimore për planifikim dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë në nivel komunal.

Tabela vjetore e aktiviteteteve kryesore të planifikuara për vitin 2026

Nr.	Aktiviteti	Periudha e realizimit	Bartësi / Zbatuesi	Treguesi i realizimit
1	Miratimi i planit të punës së Sektorit për Arsim	Janar	SA/DA	Integrimi në planin e DA-së dhe publikimi në ueb faqe të komunës
2	Hartimi i kalendarit vjetor për vizitat monitoruese dhe mbështetëse ne institucionet arsimore	Janar	SA	Kalendari vjetor i specifikuar
3	Identifikimi dhe adresimi i nevojave për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore	Janar	Komisioni/SA	Raport për kryetarin e komunës
4	Koordinimi i përzgjedhjes se mësimdhënësit të dalluar në nivel shkolle	Janar	SA/DA/ IEAA	Vendimi dhe dosja e mësimdhënësit te përzgjedhur
5	Identifikimi i nevojave individuale për Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve (ZhPM)	Janar	SA/IEAA	Pasqyra e të dhënave përmes pyetësorit
6	Analiza e përzgjedhjes së Koordinatorëve të Cilësisë (KC) dhe nxjerrja e rekomandimeve	Janar-Shkurt	SA	Raporti për të gjithë KC të përzgjedhur në të gjitha shkollat
7	Plotësim-ndryshimi i Ekipit për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore	Janar-Shkurt	SA/DA	Vendimi i ekipit sipas UA nr. 02/2024
8	Përzgjedhja e mësimdhënësit të dalluar në nivel shkolle dhe komune	Janar-Shkurt	SA/SAF/ DA	Vendim i përzgjedhjes/Mirënjohjet
9	Organizimi i garave komunale të fizikës	Janar-Mars	SA/IEAA/ SHF	Rezultatet e garave/Çmimet/ Mirënjohjet
10	Organizimi i garave në nivel vendi të matematikës	Janar-Mars	SA/IEAA/ SHM	Rezultatet e garave/Çmimet/ Mirënjohjet
11	Takimi i rregullt me Policinë e Kosovës (Njësinë për Komunitet)	Janar-Prill Tetor-Dhjetor	SA/DA/PK/ IEAA	Raportet e takimeve/Procesverbalet e takimeve

Nr.	Aktiviteti	Periudha e realizimit	Bartësi / Zbatuesi	Treguesi i realizimit
12	Raporti përmbledhës në fund të secilit gjysmëvjetor	Janar, Korrik	SA/IEAA	Raportet e shkollave/Raporti Analitik përmbledhës i SA-së
13	Analiza e suksesit në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025/26	Shkurt	SA/IEAA	Raportet nga shkollat/Raporti nga SMIA/Raporti analitik i SA
14	Analiza e situatës së nxënësve të komuniteteve	Shkurt	SA	Raporti i përfshirjes së nxënësve minoritar në IEAA
15	Koordinimi i organizimit të aktiviteteve për 17 Shkurt	Shkurt	SA/IEAA	Raportet e shkollave për aktivitete të realizuara
16	Formimi i Këshillit të Prindërve të Komunës (KPk)	Shkurt	SA/IEAA	Vendimi i kryesisë së KPK/Procesverbali i takimit
17	Incizimi dhe analiza e rënies së numrit të nxënësve me fokus në zonat rurale dhe ShML si dhe ndikimi i tyre në normat e mësimdhënësve	Shkurt	SA	Raporti me rekomandime
18	Themelimi i ekipit komunal për planifikim dhe mbështetje shkollave për realizimin e VPM-së për përtëritje të licencës	Shkurt	SA/DA	Vendimi i ekipit
19	Mbledhje të rregullta me drejtor shkollash	Shkurt, Maj, Gusht, Dhjetor	SA/DA/IEAA	Procesverbalet e takimeve
20	Organizimi i punëtorive për SMIA	Shkurt-Qershor	SA/SAF/DA/IEAA	Raporti për nr. e punëtorive të mbajtura (Listat e pjesëmarrjes)
21	Organizimi i trajnimit dy ditor për secilin mësimdhënës	Shkurt-Dhjetor	SA/DA/IEAA	Certifikimi i secilit mësimdhënës me 16 orë kredi
22	Realizimi i vizitave monitoruese dhe mbështetëse në shkolla për mbarëvajtjen e përgjithshme	Shkurt-Nëntor	SA/IEAA	Raportet e vizitave me adresime dhe rekomandime
23	Rithemelimi i EPRBM komunale	Mars	SA/DA	Vendimi i EPRBM komunale

Nr.	Aktiviteti	Periodha e realizimit	Bartësi / Zbatuesi	Treguesi i realizimit
24	Organizimi i fushatave vetëdijësuese në komunitetet jo shumicë	Mars-Prill	SA/SAF/DA/IEAA	Raporti për nr. e fushatave të realizuara (Lista e pjesëmarrjes)
25	Trajnimi i EPRBM komunale dhe shkollore	Mars-Maj	SA	Raporti për trajnimet e mbajtura /Listat e pjesëmarrjes
26	Punëtori me Koordinatorët e Cilësisë	Mars-Qershor	SA/KC	Listat e pjesëmarrjes
27	Plotësim/ndryshimi i Rregullores komunale për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore	Mars-Qershor	SA/DA/ZK/ZI	Aprovimi i Rregullores me ndryshim-plotësime në Kuvendin Komunal
28	Krijimi i rrjetit të stafit profesional mbështetës në nivel komune	Mars	SA/DA	Struktura udhëheqëse e rrjetit/Procesverbali
29	Krijimi i rrjetit të KC në nivel komune	Prill	SA/DA	Struktura udhëheqëse e rrjetit/Procesverbali
30	Organizimi i aktiviteteve për orientim në karrierë (kl. 6–9)	Prill-Maj	SA / IEAA	Numri i sesioneve të mbajtura
31	Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2026-2029	Prill-Nëntor	SA/SAF/DA/ZK/ZI/KK/Partnerët	Aprovimi i planit në Kuvendin Komunal
32	Hartimi i planit të veprimit për siguri në shkollë 2026-2029	Prill-Shtator	SA/SAF/DA/ZK/ZI/KK/Partnerët	Aprovimi i planit në Kuvendin Komunal
33	Organizimi i Testit të Arritshmërisë	Maj	Spektori / MASHTI/IEAA	Raportet e shkollave dhe SA / Rezultatet e testit
34	Fuqizimi i Aktiveve Profesionale (AP) në të gjitha IEAA dhe krijimi i AP në nivel komune	Maj	SA/DA/IEAA	Vendimet e AP-ve/Procesverbalet/Struktura drejtuese e AP-ve në nivel komune
35	Koordinimi i organizimit të Festës së Abetares	Maj	SA/IEAA	Raportet e shkollave
36	Koordinimi për organizimin e javës së dyerve të hapura	Maj	SA/IEAA/MASHTI	Raporti për numrin e pjesëmarrësve

Nr.	Aktiviteti	Periudha e realizimit	Bartësi / Zbatuesi	Treguesi i realizimit
37	Koordinimi i regjistrimit të nxënësve në IP dhe klasën përgatitore si dhe në klasën e parë	Maj-Qershor	SA/IEAA/ MASHTI	Raportet e shkollave/Raportet nga SMIA
38	Organizimi i Testit të Maturës Shtetërore	Qershor, Gusht	SA / MASHTI/ IEAA	Raportet e shkollave dhe SA / Rezultatet e testit
39	Koordinimi i procesit të regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë në gjimnaz dhe IAAP	Qershor–Gusht	SA/IEAA/ MASHTI/SIA	Raportet e shkollave/Raportet nga SMIA
40	Analiza e suksesit në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2025/26	Korrik	SA/IEAA	Raportet nga shkollat/Raporti nga SMIA/Raporti analitik i SA
41	Koordinimi i organizimit të aktiviteteve për festat e Nëntorit	Nëntor	SA/IEAA	Raportet e shkollave
42	Organizimi i garave shkollore të fizikës	Dhjetor	IEAA	Rezultatet e garave/Mirënjohjet
43	Organizimi i takimit me mësimdhënësit e pensionuar	Dhjetor	SA/SAF/ DA/IEAA	Raporti i ceremonisë/Lista e mirënjohjeve
44	Organizimi i garave shkollore dhe komunale të matematikës	Dhjetor	IEAA	Rezultatet e garave/Mirënjohjet
45	Raporti i punës së Sektorit për Arsim	Dhjetor	SA	Integrimi në raportin e DA-së/Publikimi
46	Hartimi i planit të punës së Sektorit për Arsim	Janar	SA/DA	Integrimi në planin e DA-së
47	Raportet e rregullta mujore të IEAA	Çdo muaj	SA/IEAA	Raportet mujore të IEAA/Raportet përmbledhëse të SA
48	Koordinimi i organizimit të ligjëratave në shkollë nga Njësia e Komunitetit të Policisë së Kosovës	Gjatë vitit	SA/PK/IEAA	Raporti për ligjëratat e mbajtura
49	Mbështetje e shkollave për ZhPMBSH	Gjatë vitit	SA / MASHTI/ IEAA	Raporti për numrin e të trajnuarve dhe certifikuarve
50	Koordinimi i praktikës pedagogjike të studentëve	Gjatë vitit	SA/UMIB/UP/ IEAA	Raportet e shkollave/Listat e studentëve që kanë realizuar praktikën në shkollë

Nr.	Aktiviteti	Periudha e realizimit	Bartësi / Zbatuesi	Treguesi i realizimit
51	Koordinimi i vlerësimit të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore	Gjatë vitit	SA/SAF/ EVPFNVA/ IEAA	Raporti me nr. të vlerësimeve
52	Shqyrtimi i rasteve me tendencë të braktisjes dhe parandalimi i braktisjes	Gjatë vitit	SA/EPRBM komunale dhe shkollore	Raporti me rastet e trajtuara
53	Nxitja dhe harmonizimi i bashkëpunimit midis mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe IEAA	Gjatë vitit	SA/IEAA/ KPk/ Partnerët	Nr. i takimeve / bashkëpunimeve të dokumentuara
54	Bashkëpunimi me SIA për kontrollin dhe vlerësimin e punës në institucionet arsimore	Gjatë vitit	SA/DA	Nr. i inspektimeve dhe raporteve
55	Sugjerime për përmirësimin e procesit edukativo-arsimor dhe reformave	Gjatë vitit	SA	Nr. i raporteve / sugjerimeve të dorëzuara
56	Organizimi i aktiviteteve motivuese dhe promovuese për mësimdhënësit dhe nxënësit	Gjatë vitit	SA/ IEAA/ Partnerët	Nr. i aktiviteteve dhe pjesëmarrësve
57	Koordinimi me prindër dhe shkolla për nxënësit e riatdhesuar	Gjatë vitit	SA/MAShTI/ IEAA	Raporti për numrin e nxënësve të riatdhesuar
58	Realizimi i aktiviteteve të tjera të monitorimit dhe raportimit të të dhënave në SMIA	Gjatë vitit	SA/IEAA	Raporte për të dhënat e regjistruara
59	Zbatimi i aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit për Parandalimin e Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Shkollë 2024-2026	Gjatë vitit	SA/DA/IEAA/ MAShTI/PK/QPS/ Partnerët	Raportet për aktivitetet e realizuara
60	Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitutional dhe ndërsektorial	Gjatë vitit	SA/DA/ MAShTI/QPS, PK	Raportet përkatëse
61	Punë me palë (personel arsimor, prindër, nxënës, etj.)	Gjatë vitit	SA	Evidenca e takimeve

Të dhënat e përgjithshme


Vitin e ri shkollor 2025/26 e kanë filluar 13,330 nxënës që i vijojnë mësimet në 39 institucionet arsimore të mëposhtme:

- 2 Institucione Parashkollore (IP);
- 26 Shkolla Filllore të Mesme të Ulëta (ShFMU);
- 6 Paralele të ndara të Shkollave Filllore të Mesme të Ulëta (ShFMU);
- 5 Shkolla të Mesme të Larta (ShML);

Numri i nxënësve sipas niveleve shkollore

Sipas të dhënave zyrtare të regjistruara në SMIA, numri i nxënësve në institucionet parashkollore është 466 fëmijë (359 në çerdhe dhe 107 në shkolla për grup-moshat 3-5 vjeç); në nivelin parafillor/klasa përgatitore 688 nxënës, në nivelin fillor 4809 nxënës, në nivelin e mesëm të ulët 4137 nxënës dhe në nivelin e mesëm të lartë 3230 nxënës.

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve që janë përfshirë në të gjitha nivelet shkollore, numri më i madh i nxënësve është në arsimin fillor (36% e numrit të përgjithshëm), ndërsa numri më i vogël i fëmijëve është në arsimin parashkollor (4% e numrit të përgjithshëm).



Të dhënat e tjera, sipas klasave për nivele shkollore, mund t'i shihni në tabelarin e mëposhtëm:

Klasa/Niveli	Mashkull	Femër	Gjithsej
Grupa 1-2	35	23	58
Grupa 2-3	38	29	67
Grupa 3-4	64	67	131
Grupa 4-5	64	77	141
Grupa 5-6 – Parashkollor (Çerdhe)	41	28	69
Gjithsej Parashkollor (0-5 vjeç)	242	224	466
Gjithsej Parafillor (Klasa përgatitore)	361	327	688
Klasa 1	439	474	913
Klasa 2	481	458	939
Klasa 3	520	492	1012
Klasa 4	484	466	950
Klasa 5	497	498	995
Gjithsej Arsimi Fillor (Klasa 1-5)	2421	2388	4809
Klasa 6	555	497	1052
Klasa 7	532	470	1002
Klasa 8	473	540	1013
Klasa 9	563	507	1070
Gjithsej Arsimi i Mesëm i Ulët (Klasa 6-9)	2123	2014	4137
Klasa 10	559	615	1174
Klasa 11	474	573	1047
Klasa 12	436	573	1009
Gjithsej Arsimi i Mesëm i Lartë (Klasa 10-12)	1469	1761	3230
Gjithsej nxënës në të gjitha nivelet shkollore	6616	6714	13330

Pasqyra e numrit të paraleleve sipas klasave

Grupet/Klasat																			
Nr.	3	3	6	7	34	3	68	68	72	72	65	65	63	66	56	50	47	53	801
Grupa 1-2																			
Grupa 2-3																			
Grupa 3-4																			
Grupa 4-5																			
Grupa 5-6 - Parafillor																			
Grupa 5-6 - Parashkollor(Çerdhe)																			
Klasa 1																			
Klasa 2																			
Klasa 3																			
Klasa 4																			
Klasa 5																			
Klasa 6																			
Klasa 7																			
Klasa 8																			
Klasa 9																			
Klasa 10																			
Klasa 11																			
Klasa 12																			
Gjithsej paralele																			

Pasqyra e numrit të nxënësve sipas Institucioneve Edukativo - Arsimore

Nr.	Institucionet edukativo-arsimore	Numri i nxënësve
1	IP "Dritë Dielli"	87
2	IP "Gëzimi Ynë"	272
3	ShFMU "Abdullah Shabani"	956
4	ShFMU "Andon Zako Çajupi"	724
5	ShFMU "Avni Shabani"	10
6	ShFMU "Aziz Sylejmani"	105
7	ShFMU "Aziz Sylejmani"-PN	17
8	ShFMU "Aziz Sylejmani"-PN	128
9	ShFMU "Bedri Gjinaj"	413
10	ShFMU "Bislim Imeri"	256
11	ShFMU "Dëshmorët e Kaçanollit"	3
12	ShFMU "Elena Gjika"	180
13	ShFMU "Elmaz Peci"	27
14	ShFMU "Eqrem Çabej"	925
15	ShFMU "Fazli Greiçevci"	631
16	ShFMU "Fazli Greiçevci" - PN	139
17	ShFMU "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"	634
18	ShFMU "Harun Beka"	207
19	ShFMU "Harun Beka" - PN	9
20	ShFMU "Ismail Qemali"	731
21	ShFMU "Jashar Begu"	20
22	ShFMU "Jusuf Rexha"	224
23	ShFMU "Mehë Uka"	30
24	ShFMU "Migjeni"	990
25	ShFMU "Musa Hoti"	804
26	ShFMU "Musa Hoti" - PN	157
27	ShFMU "Nonda Bulka"	230
28	ShFMU "Sefedin Smakolli"	22
29	ShFMU "Shaban Idriizi"	423
30	ShFMU "Shemsi Ahmeti"	231
31	ShFMU "Sylejman Vokshi"	154
32	ShFMU "Trepça"	114
33	ShFMU "Trepça" - PN	6
34	ShFMU "Xhevat Jusufi"	38
35	Gjimnazi "Frang Bardhi"	1035
36	ShMLE "Hasan Prishtina"	739
37	ShMLM "Dr. Xheladin Deda"	1006
38	ShMLT "Arkitekt Sinani"	427
39	ShMUA/ShMLA "Tefta Tashko"	226
Gjithsej		13330

Numri i nxënësve sipas strukturës etnike në vitin shkollor 2025/26

Siç jeni në dijeni, mësimi në komunën tonë organizohet edhe në gjuhën boshnjake (ShFMU “Bedri Gjinaj”; Gjimnazi “Frang Bardhi”) dhe në gjuhën turke në ShFMU “A. Z. Çajupi”. Nxënësit e minoritetit Ashkalinjë, Romë dhe Egjiptianë e vijnë në mësimin në gjuhën shqipe dhe janë të integruar në klasat e rregullta me nxënësit shqiptar. Numri i nxënësve shumicë (shqiptar) është 13232, ndërsa nxënës minoritar në nivel komune janë 98 nxënës.

Përkatësia etnike	Shqiptar	Turq	Boshnjak	Ashkalinjë	Romë	Egjiptianë	Tjetër
Numri i nxënësve	13232	25	11	53	1	3	5

Numri i nxënësve me nevoja të veçanta në vitin shkollor 2025/26

Numri i nxënësve me nevoja të veçanta, që do ta ndjekin mësimin në këtë vit shkollor, në nivel komune është 173 nxënës, për të gjitha nivelet shkollore. Kuptohet, ky numër është i deklaruar nga shkollat në *Bazën e të dhënave zyrtare - SMIA* (Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim).

Lloji i dëmtimeve	Numri i nxënësve
Dëmtime intelektuale	23
Dëmtime në të dëgjuar	4
Dëmtime në të parë	6
Dëmtime fizike	12
Dëmtime të shumfishta	19
Vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës	34
Autizëm	28
Çrregullime emocionale dhe të sjelljes	12
Vështirësi/Çrregullime në të nxënë	26
Sindromi Daun	9
Gjithsej	173

Sektori për Administratë dhe Financa

Plani i punës së Sektorit për Administratë dhe Financa (SAF) është përgatitur duke u bazuar në obligimet dhe detyrat që dalin nga natyra e sektorit në kuadër të Drejtorisë së Arsimit. Aktivitetet të cilat kryhen në kuadër të sektorit për Administratë dhe Financa janë të rregulluara me ligje dhe rregullore financiare dhe administrative për pjesën më të madhe të tyre.

Aktivitetet e Sektorit për Administratë dhe Financa lidhen direkt me të gjitha çështjet Administrative dhe Financiare të Drejtorisë së Arsimit duke përfshirë edhe të gjitha shkollat e Komunës së Mitrovicës të cilat menaxhohen nga Drejtoria e Arsimit..

Konsolidimi financiar në Arsimin e Mitrovicës, kryesisht lidhet me Sektorin për Administratë dhe Financa. Administrimi i kërkesave për punë, furnizimet dhe shërbime të institucioneve parauniversitare në Komunen e Mitrovicës, poashtu është pjesë e planit të punës së SAF.

Pra të gjitha çështjet financiare nga planifikimi dhe realizimi buxhetit janë të lidhura me sektorin tone, të Drejtorisë së Arsimit dhe të gjitha shkollave në Komunën e Mitrovicës.

Objektivat e Sektorit për Administratë

Përcaktimi i objektivave në Sektorin për Administratë dhe Financa, lidhet ngushtë me ngritjen e transparencën financiare dhe sigurisë së respektimit të ligjeve dhe Rregullore financiare me qëllim të realizimit të objektivave të Drejtorisë së Arsimit, rrjedhimisht edhe të të gjitha Institucioneve arsimore parauniversitare në Komunën tone.

Për vitin 2026 si objektiva kryesore ne kemi vendosur :

1. Ngritja e llogaridhenies dhe transparenca financiare
2. Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave me theks të veçantë sistemi i ngrohjes
3. Rifreskimi i menaxhimit dhe koordinimit të aktiviteteve

Objektivat e këtij plani janë të lidhura direkt me qëllimin e funksionimit të sektorit për Administratë dhe Financa në kuadër të Drejtorisë së Arsimit. Organizimi dhe delegimi i detyrave të detajizuara ka për qëllim të ngritë performancën e SAF dhe dhe arritjen e objektivave për secilin zyrtar në vecanti.

Realizimi i planit do të raportohet në baza tremujore dhe sipas arritjes së rezultateve do të azhurohet edhe ky plan. Në fund të vitit do të kemi mundësi të bëjmë vlersimin e performances dhe arritjen e objektivave, duke u bazuar në këtë plan.

Respektimi i ligjeve dhe akteve nën ligjore në fuqi do të jetë aktiviteti kryesor i Sektorit për Administratë dhe Financa.

Aktivitetet e Sektorit për Buxhet dhe Financa në vitin 2026

Gjatë vitit ky plan do të rishikohet disa here sipas nevojës dhe do të plotësohet me ndryshimet e kërkuara. Plani do të raportohet ne periudha tremujore për realizimin e tij. Realizimi i këtij plani do të ndikoj në performancën e Drejtorisë së Arsimit. Në vazhdim do të prezentojmë të gjitha aktivitetet dhe rezultatet e pritura të Sektorit për Administratë dhe Financa në detaje për të gjitha punët për të cilat SAF është përgjegjës për planifikimin, përgatitjen, realizimin dhe raportimin e tyre.

Muaji	Aktivitetet/Detyrat	Përshkrimi i punëve	Rezultati i pritur	Afati Kohor
Janar	Pranimi i Kërkesave për ndryshime në Paga	Pranimi i të gjitha kërkesave nga Institucionet Arsimore për ndryshime në Paga.	Raport mbi të gjitha kërkesat	...08.Janar
	Pasuria	Azhurimi i regjistrit të Pasurisë të Institucioneve Arsimore në K.Omunën e Mitrovicës. Azhurimi i regjistrit të inventarit duke u bazuar në raportin e Komisioneve të shkollave për Evidentim të Inventarit i emëruar nga Drejtori i Shkollës.	Raport detaj i regjistrimit të Pasurisë	...12 Janar
	Takimi fillestar	Takimi me zyrtarët e SAF për të identifikuar kërkesat, detyrat dhe obligimet e tyre për vitin 2026.	Organizimi i vitit 2024	12 Janar
	Ndryshimet në Paga	Përgatitja e formularëve për ndryshimet në Paga dhe dorëzimi i tyre në Divizionin e Pagave të Ministrisë së Financave.	Ekzekutimi i pagave me të gjitha ndryshimet ligjore.	...12 Janar
	Pushimet Vjetore	Planifikimi i pushimit vjetor për vitin 2026 nga zyrtarët e SFB.	Mungesat e zyrtarëve të mos ndikojnë në kryerjen e detyrave dhe obligimeve në SAF	...15 Janar
	Raporti Vjetor	Mbledhja e raporteve nga zyrtarët e sektorit për punët e përfunduara gjatë muajit dhjetor 2025. Përgatitjen e Raportit të punës për muajin dhjetor dhe RAPORTIT VJETOR 2026	Raportimi te Drejtori i Arsimit për të gjitha aktivitetet e kryera në SBF gjatë vitit 2025.	...15.Janar

	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen raporti të obligimeve të papaguara dhe bartja e tyre nga viti 2025 në vitin 2026 sipas katgorive ekonomike. Identifikimi i rreziqeve nga moskryerja e obligimeve ndaj OE.	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Drejtorisë së Arsimit Forcimi i Kontrollit të Brendshëm	...15 Janar
	Qasja në SIMFK	Përgatitja e kërkesave për qasje në SIMFK.	Qasja për Alokime dhe Nënaloqime.	...31 Janar
	Miratimi/Refuzimi i kërkesave	Raporti detaj për të gjitha kërkesat e Shkollave : Të Miratuara dhe të Refuzuara	Analiza e miratimit dhe refuzimit të lëndëve	...31 Janar
	Alokimi i Buxhetit	Njoftimi i të gjitha Shkollave për Planin e Shpenzimeve në SIMFK/	Informimi në kohë mbi alokimet buxhetore nga të gjitha fondet burimore	Janar
	Cash Flow	Përgatitja e CashFlow duke u bazuar në ndarjet buxhetore të ligjit të Buxhetit 2025 dhe prioritetet e Shkollave	Alokimet e mjeteve në baza periodike në përputhje me prioritetet e përcaktuara.	Janar
	Zotimet	Zotimet e të gjitha aktiviteteve afatgjate duke përfshirë kategorinë e Mallra dhe Shërbimeve dhe Investimeve Kapitale.	Parashikimi i shpenzeimeve rrjedhëse dhe zotimi i mjeteve.	Janar
	Disponueshmëritë e Mjeteve	Përgatitja e formularëve për Deklaratat e nevojave dhe Disponueshmëritë e mjeteve për të gjitha projektet kapitale dhe kontratat të cilat do të inicohen gjatë vitit 2026 nga Drejtoria e Arsimit.	Parapërgatitje për fillimin e procedurave të Prokurimit 2026	Janar
	Vlerësimi i Stafit	Vlerësimi i stafit sipas kriterëve të përcaktuara me Rregullore, për punët punët e realizuara gjatë vitit 2025	Performanca e stafit të SAF.	Janar
Shkurt	Raporti i punës Janar 2026	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SAF dhe përgatitja e Raportit Mjor.	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	...05 shkurt
	Ndryshimet në Paga	Përgatitja e formularëve për ndryshimet në Paga dhe dorëzimi i tyre në Divizionin e Pagave të Ministrisë së Financave.	Ekzekutimi i pagave me të gjitha ndryshimet ligjore.	...10 shkurt
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Janar 2026	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Drejtorisë së Arsimit + Shkollave	...15 shkurt

	Hartimi i Specifikave të projekteve	Finalizimi i të gjitha specifikave të tenderëve për projektet kapitale	Raport mbi të gjithë tenderët që do të inicohen gjatë vitit nga Drejtoria e Arsimit.	...20 shkurt
	Plani i Prokurimit	Rifreskimi i Planit mbi procedurat e prokurimit për vitin aktual	Raport i freskuar mbi ecurinë e imlementimit të Prokurimeve nga Drejtoria e Arsimit	...20 shkurt
	Inicimi i të gjitha tenderëve për Investime Kapitale në Arsim	Inicimi i të gjitha tenderëve për prokurim në Zyren e Prokurimit të Komunës së Mitrovicës	Shpallja e tenderëve në kohë në mënyrë që të gjitha kontratat ti kemi active deri në gjysmë të muajit Prill	...15 shkurt
Mars	Raporti i punës Shkurt 2026	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SAF dhe përgatitja e Raportit Mujor.	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	...05 Mars
	Organizimi i Eventit për mësimdhënësit e Dalluar	Organizimi i ceremonies për përzgjedhjen e mësimdhënësve të dalluar për vitin mësimor aktual	Ceremoni solemne për pranimin e mirëmnjohjeve nga mësimdhënësit dhe prezenetimi i projekteve kapitale	07 Mars
	Ndryshimet në Paga	Përgatitja e formularëve për ndryshimet në Paga dhe dorëzimi i tyre në Divizionin e Pagave të Ministrisë së Financave.	Ekzekutimi i pagave me të gjitha ndryshimet ligjore.	...10 Mars
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Shkurt	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Drejtorisë së Arsimit + Shkollave	...15 Mars
	Plani i Prokurimit	Rifreskimi i Planit mbi procedurat e prokurimit për vitin aktual	Raport i freskuar mbi ecurinë e imlementimit të Prokurimeve nga Drejtoria e Arsimit	...20 Mars
Prill	Raporti i punës Mars 2026	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SAF dhe përgatitja e Raportit Mujor.	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	...05 Prill
	Rishikimi i Planit Vjetor të Punës	Organizimi i takimit për të rishikuar PVP dhe për të analizuar implementimin e tij dhe ndryshimet e nevojshme.	Realizimi i Planit Vjetor të Punës.	09 Prill
	Raport mbi	Raport mbi faturat e pranuar nga Drejtoria e Arsimit	Analiza mbi punët dhe shërbimet e pranuar	...10 Prill

	faturat e pranuara TM1 2026		nga Drejtoria e Arsimit dhe krahasimi i tyre	
	Ndryshimet në Paga	Përgatitja e formularëve për ndryshimet në Paga dhe dorëzimi i tyre në Divizionin e Pagave të Ministrisë së Financave.	Ekzekutimi i pagave me të gjitha ndryshimet ligjore.	...10 Prill
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Mars	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Drejtorisë së Arsimit + Shkollave	...15 Prill
	Miratimi/Refuzimi i kërkesave	Raporti detaj për të gjitha kërkesat e Shkollave : Të Miratuara dhe të Refuzuara / Përveç faturave Për TM1	Analiza e miratimit dhe refuzimit të lëndëve	...30 Prill
	Plani i Prokurimit	Rifreskimi i Planit mbi procedurat e prokurimit për vitin 2026	Raport i freskuar mbi ecurinë e imlementimit të Prokurimeve nga Drejtoria e Arsimit	...30 Prill
Maj	Raporti i punës Prill 2026	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SAF dhe përgatitja e Raportit Mjor.	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	...05 Maj
	Ndryshimet në Paga	Përgatitja e formularëve për ndryshimet në Paga dhe dorëzimi i tyre në Divizionin e Pagave të Ministrisë së Financave.	Ekzekutimi i pagave me të gjitha ndryshimet ligjore.	...10 Maj
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Prill	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Drejtorisë së Arsimit + Shkollave	...15 Maj
	Qarkorja Buxhetore 2027/01	Njoftimi me Qarkoren Buxhetore 2027/01 dhe përgatitja e buxhetit fillestar për të gjitha Shkollat.	Raport mbi Planifikimin fillestar për ndarjen e buxhetit 2027	...25 Maj
	Plani i Prokurimit	Rifreskimi i Planit mbi procedurat e prokurimit për vitin aktual.	Raport i freskuar mbi ecurinë e imlementimit të Prokurimeve nga Drejtoria e Arsimit	...30 Maj
Qershor	Raporti i punës Maj 2026	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SAF dhe përgatitja e Raportit Mjor.	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	...05 Qershor
	Ndryshimet në Paga	Përgatitja e formularëve për ndryshimet në Paga dhe dorëzimi i tyre në Divizionin e Pagave të Ministrisë së Financave.	Ekzekutimi i pagave me të gjitha ndryshimet ligjore.	...10 Qershor
	Obligimet e	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara	...15 Qershor

	Papaguara	muajit Maj	të Drejtorisë së Arsimit + Shkollave	
	Korniza Afatmesme Buxhetore	Ndarja e Buxhetit për Drejtorinë e Arsimit dhe të gjitha shkollat sipas fondeve burimore dhe kufijve të përcaktuar në KAB.	Identifikimi i kufijve buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike	...20 Qershor Dorëzimi DBF
	Plani i Prokurimit	Rifreskimi i Planit mbi procedurat e prokurimit për vitin aktual	Raport i freskuar mbi ecurinë e imlementimit të Prokurimeve nga Drejtoria e Arsimit	...30.06.2024
Korrik	Rishikimi i Planit Vjetor të Punës	Organizimi i takimit për të rishikuar PVP dhe për të analizuar implementimin e tij dhe ndryshimet e nevojshme.	Realizimi i Planit Vjetor të Punës.	01 Korrik
	Raporti i punës Qershor 2026	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SAF dhe përgatitja e Raportit Mujor.	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	...05 Korrik
	Raport mbi faturat e pranuar TM2 2026	Raport mbi faturat e pranuar nga Drejtoria e Arsimit	Analiza mbi punët dhe shërbimet e pranuar nga Drejtoria e Arsimit dhe krahasimi i tyre	...10 Korrik
	Ndryshimet në Paga	Përgatitja e formularëve për ndryshimet në Paga dhe dorëzimi i tyre në Divizionin e Pagave të Ministrisë së Financave.	Ekzekutimi i pagave me të gjitha ndryshimet ligjore.	...10 Korrik
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Qershor	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Drejtorisë së Arsimit + Shkollave	...15 Korrik
	Dëgjimet Buxhetore me Drejtor/e të Shkollave	Organizimi i dëgjimeve buxhetore me drejtor/e të shkollave në kaudër të procesit të planifikimit të Buxhetit 2025-2027.	Identifikimi i kërkesave financiare të Drejtoreshave për vitin 2026	03 – 07 korrik
	Raporti mbi Dëgjimet Buxhetore me Drejtor Shkollash	Filtrimi i kërkesave të drejtoreshave gjatë dëgjimeve buxhetore, eliminimi i kërkesave të përsëritura dhe Përgatitja e Raportit mbi dëgjimet buxhetore me Drejtor/e	Përmbledhja e kërkesave të Drejtoreshave	...10 Korrik
	Plani i Prokurimit	Rifreskimi i Planit mbi procedurat e prokurimit për vitin 2024.	Raport i freskuar mbi ecurinë e imlementimit të	...30 Korrik

			Prokurimeve nga Drejtoria e Arsimit	
Gusht	Raporti i punës Korrik 2026	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SAF dhe përgatitja e Raportit Mjor.	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	...05 Gusht
	Ndryshimet në Paga	Përgatitja e formularëve për ndryshimet në Paga dhe dorëzimi i tyre në Divizionin e Pagave të Ministrisë së Financave.	Ekzekutimi i pagave me të gjitha ndryshimet ligjore.	...10 Gusht
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Korrik	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Drejtorisë së Arsimit + Shkollave	...15 Gusht
	Furnizimi i furnizimit me material administrative	Furnizimi i shkollave me të gjitha materialet administrative për vitin shkollor	Krijimi i kushteve administrative për komplet vitin shkollor	...30 Gusht
	Furnizimi i furnizimit me material Higjienik	Furnizimi i shkollave me të gjitha materialet higjienike për vitin shkollor	Krijimi i kushteve higjienike për komplet vitin shkollor	...30 Gusht
	Furnizimi i furnizimit me Lëndë Djegëse Naftë	Furnizimi i shkollave me të gjitha lende djegëse per ngrohje për vitin shkollor	Krijimi i kushteve te ngrohjes për komplet vitin shkollor	...30 Gusht
	Furnizimi i furnizimit me Lëndë Djegëse Dru	Furnizimi i shkollave me të gjitha lende djegëse per ngrohje për vitin shkollor	Krijimi i kushteve te ngrohjes për komplet vitin shkollor	...30 Gusht
	Furnizimi i furnizimit me Lëndë Djegëse Pelet	Furnizimi i shkollave me të gjitha lende djegëse per ngrohje për vitin shkollor	Krijimi i kushteve te ngrohjes për komplet vitin shkollor	...30 Gusht

	Buxheti 2027-2030	Finalizimi i Draft-Buxhetit dhe procedimi te DBF	Aprovimi i Draft-Buxhetit	Gusht
Shtator	Raporti i punës Gusht 2026	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SAF dhe përgatitja e Raportit Mjor.	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	...05 Shtator
	Ndryshimet në Paga	Përgatitja e formularëve për ndryshimet në Paga dhe dorëzimi i tyre në Divizionin e Pagave të Ministrisë së Financave.	Ekzekutimi i pagave me të gjitha ndryshimet ligjore.	...10 Shtator
	Finalizimi i furnizimit me lëndë djegëse	Furnizimi me lëndë djegëse (DRU, PELET dhe NAFTE) Faturimi dhe ekzekutimi I pagesave	Raport mbi furnizimet me lëndë djegëse.	...15 Shtator
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Gusht 2024	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Drejtorisë së Arsimit + Shkollave	...15 Shtator
Tetor	Rishikimi i Planit Vjetor të Punës	Organizimi i takimit për të rishikuar PVP dhe për të analizuar implementimin e tij dhe ndryshimet e nevojshme.	Realizimi i Planit Vjetor të Punës.	01.10.2024
	Raporti i punës Shtator 2026	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SAF dhe përgatitja e Raportit Mjor.	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	...05 Tetor
	Raport mbi faturat e pranura TM3 2026	Raport mbi faturat e pranura nga Drejtoria e Arsimit	Analiza mbi punët dhe shërbimet e pranura nga Drejtoria e Arsimit dha krahasimi i tyre	...10 Tetor
	Ndryshimet në Paga	Përgatitja e formularëve për ndryshimet në Paga dhe dorëzimi i tyre në Divizionin e Pagave të Ministrisë së Financave.	Ekzekutimi i pagave me të gjitha ndryshimet ligjore.	...10 Tetor
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Shtator 2026	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Drejtorisë së Arsimit + Shkollave	...15 Tetor
	Miratimi/Refuzimi i kërkesave	Raport detaj për të gjitha kërkesat e drejtorive tjera : Të Miratuara dhe të Refuzuara / Përveç faturave Për TM3	Analiza e miratimit dhe refuzimit të lëndëve	...31 Tetor
	Mbyllja e Afatit të Zotimeve	Njoftimi paraprak i Shkollave për mbylljen e afatit të zotimeve për kategorinë ekonomike të Investimeve Kapitale .	Efikasiteti i zotimit të mjeteve	31 Tetor
Nëntor	Raporti i punës	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SAF dhe përgatitja	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe	...05 Nëntor

	Tetor 2026	e Raportit Mujor.	raportimi i tyre	
	Ndryshimet në Paga	Përgatitja e formularëve për ndryshimet në Paga dhe dorëzimi i tyre në Divizionin e Pagave të Ministrisë së Financave.	Ekzekutimi i pagave me të gjitha ndryshimet ligjore.	...10 Netor
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Tetor 2026	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Drejtorisë së Arsimit + Shkollave	...15. nentor
	Mbyllja e Afatit të Zotimeve	Njoftimi paraprak i Shkollave për mbylljen e afatit të zotimeve për kategorinë ekonomike të Mallrave dhe Shërbimeve .	Efikasiteti i zotimit të mjeteve	26 Nëntor
Dhjetor	Raporti i punës Nëntor 2026	Mbledhja e raporteve të punës nga zyrtarët e SAF dhe përgatitja e Raportit Mujor.	Krahasimi i punëve në raport me planin dhe raportimi i tyre	...05 Dhjetor
	Ndryshimet në Paga	Përgatitja e formularëve për ndryshimet në Paga dhe dorëzimi i tyre në Divizionin e Pagave të Ministrisë së Financave.	Ekzekutimi i pagave me të gjitha ndryshimet ligjore.	...10 Dhjetor
	Mbyllja e afatit të Zotimeve	Njoftimi paraprak i Shkollave për mbylljen e afatit të të gjitha zotimeve për vitin 2026(përvec avanseve)	Efikasiteti i zotimit të mjeteve	12 Dhjetor
	Obligimet e Papaguara	Asistimi në përgatitjen e obligimeve të papaguara deri fund të muajit Nëntor 2026	Raportimi i obligimeve (faturave) të papaguara të Drejtorisë së Arsimit + Shkollave	...15 Dhjetor
	Mbyllja e vitit fiskal	Njoftimi paraprak i Shkollave për mbylljen e afatit të ekzekutimit të pagesave për vitin aktual	Efikasiteti i ekzekutimit të pagesave	24 Dhjetor
	Inventarizimi për vitin Aktual	Pranimi i raporteve të inventarizimit nga Shkollat	Raport për Inventarizim dhe dorëzim të zytjara e Pasurisë për vitin aktual	25 Dhjetor
	Takimi përmbyllës	Organizimi i takimit përmbyllës të stafit SAF	Analiza e realizimit të Planit Vjetor 2026	27 Dhjetor
	Plani Vjetor i Punës 2027	Mbledhja e PVP të zyrtarëve SBF dhe përgatitja e Planit Vjetor 2027	Përgatitja për vitin 2027	31 Dhjetor
	Plani i Prokurimit 2027	Përgatitja e Planit të Prokurimit për vitin 2027 dhe dorëzimi tek zyrtari përgjegjës i Prokurimit.	Raport – Planit të Prokurimit 2027	...31 Dhjetor

BUXHETI 2026 - ARSIM DHE SHKENCË

Përshkrimi	Stafi	2026					
		PAGA DHE RROGA	MALLRA DHE SHËRBIME	SHPENZIME KOMUNALE	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	SHPENZIME KAPITALE	2026
<i>d</i>	<i>e</i>	<i>f</i>	<i>g</i>	<i>h</i>	<i>i</i>	<i>j</i>	<i>k</i>
SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	1240	11,638,305.80	1,221,020.00	163,000.00	20,000.00	1,310,312.00	14,352,637.80
Granti Qeveritar - Përgjithshëm	9	1,134,753.80	100,000.00	163,000.00		1,215,000.00	2,612,753.80
Granti Specifik për Arsim	1231	10,460,552.00	951,020.00			95,312.00	11,506,884.00
Të Hyrat Vetanake	0	43,000.00	170,000.00		20,000.00		233,000.00
Administrata e Arsimit - Drejtoria	9	96,353.60	100,000.00	163,000.00	20,000.00	1,215,000.00	1,594,353.60
Granti Qeveritar - Përgjithshëm	9	96,353.60	100,000.00	163,000.00		1,215,000.00	1,574,353.60
Të Hyrat Vetanake					20,000.00		20,000.00
Arsim ParaFillor	59	481,834.06	251,020.00				732,854.06
Granti Specifik për Arsim	59	481,834.06	101,020.00				582,854.06
Të Hyrat Vetanake			150,000.00				150,000.00
Arsim Fillor	874	8,177,228.06	600,000.00				8,777,228.06
Granti Specifik për Arsim	874	8,177,228.06	600,000.00				8,777,228.06
Arsim Mesëm	298	2,882,890.08	270,000.00			95,312.00	3,248,202.08
Granti Qeveritar - Përgjithshëm		1,038,400.20					1,038,400.20
Granti Specifik për Arsim	298	1,801,489.88	250,000.00			95,312.00	2,146,801.88
Të Hyrat Vetanake		43,000.00	20,000.00				63,000.00

Drejtori i Arsimit

Shefki Begu



Sektori për Arsim

Refik Azemi

Sektori për Administratë dhe Financa

Kreshnik Zejnullahu

Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë e Jugut